



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, më 19.02.2023

Deklaratë për mediat

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural më 19.02.2022 është vënë në dijeni përmes mediave për akuzat e shtetasës G.L. e cila pretendon se nuk ka mundur të kryejë aplikimin në programin IPARD, edhe pse sipas saj kishte plotësuar të gjithë dokumentacionin dhe kriteret e nevojshme për të qënë përfitues.

Dëshirojmë të sqarojmë opinion publik në lidhje me këto akuza duke thënë se:

1. Aplikimi në programin IPARD kryhet sipas një rregulloreje të caktuar, brenda një afati të përcaktuar, duke dorëzuar dosjen e përgatitur në zyrat e Agjencisë Për Zhvillim Bujqësor dhe Rural dhe jo përmes telefonit apo personave të tjerë. Tentativat për të realizuar këtë proces me metoda të tjera i bëjnë fajtorë të gjitha palët e përfshira.
2. Në AZHBR nuk ka mbërritur asnjë ankesë nga shtetasja G.L. për të verifikuar rastin. Do të ishte më produktive që problemet të lajmërohen në kohë dhe jo pas më shumë se një vit nga thirrja e fundit e programit IPARD 2.
3. Thirrja e fundit për aplikime në programin IPARD II ka qënë në periudhën Janar 2022 – Shkurt 2022 dhe ka pasur në fokus mbështetjen mbi zhvillimin e turizmit rural, ndërsa aplikimet për investimet në blegtori kanë qënë në një datë edhe më të hershme.

Për këto arsye akuzat në rastin në fjalë janë të pa baza dhe janë abuzim i pastër mbi imazhin e një institucioni i cili ka parim bazë transparencën.

AZHBR zbaton me korrektësi të plotë çdo kriter të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore për dhënien e financimit në programet që zbaton.